

Kartat e Debitit të brandit MasterCard;

TERMAT DHE KUSHTET

Publikuar më: 01/11/2020



- Shorteu përfshin çdo klient të bankës OTP Albania i cili ka në përdorim kartë debiti të brandit **Master Card**, të tipit **Debit MasterCard** dhe **MasterCard Gold**.
- Loja promovionale do të zhvillohet gjatë periudhës **2 Nëntor 2020** deri më **30 Dhjetor 2020*** dhe çdo 2 javë do të hidhet një shorte për të përzgjedhur **3 fitues****.
- Çmimi për fituesit do të jetë një **Samsung Galaxy S20 FE & Galaxy watch**.
- Kriteret për të qenë pjesë e shorteut:

- o Kartëmbajtësi i kartës Debit MasterCard ose MasterCard Gold, duhet të performojë të paktën **3 transaksione** në **2 javë**, blerje në POS (brenda ose jashtë vendit) ose në Internet;
- o Shuma minimale e transaksionit duhet të jetë **1'000 Lekë/transaksion**;
- o Karta duhet të jetë e hapur deri në fund të fushatës. Nëse klienti e mbyll kartën para përfundimit të fushatës nuk do të jetë pjesë e lotarisë pavarësisht se plotëson kriteret e sipërpërmendura.

*Banka rezervon të drejtën e ndërprerjes së kësaj fushate, në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak.

**Klienti i cili ka rezultuar fitues në një shorte, do të përjashtohet në shorteut pasardhës.

RREGULLORE

Mbi mënyrën e organizimit të lojës promovionale "Fito duke përdorur kartën e debitit MasterCard" ORGANIZUAR NGA "OTP BANK".

Organizimi i lojës promovionale "Fito duke përdorur kartën e debitit MasterCard" bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 155/2015 "Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 196 datë 15.03.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kritereve dhe të rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale".

Kjo lojë promovionale hyn në fuqi me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë rregullore, vetëm pasi "OTP Bank" Sh.a të jetë pajisur me autorizimin paraprak nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, pranë Ministrisë së Financave.

1. Lloji i lojës promovionale

1.1 Duke filluar nga data 2 Nëntor 2020* deri 30 Dhjetor 2020, "OTP Bank" Sh.a do të organizojë një lojë promovionale për klientët individë që janë përdorues të kartave të debitit MasterCard.

1.2 Çdo 2 (dy) javë do të hidhet një shorte për të nxjerrë 3 (tre) fitues.

- Fitues do të quhet ai klient individ që kryen në 2 (dy) javë 3 (tre) ose më shumë blerje (në pikat e shitjes POS ose në Internet) me një nga kartat e debitit MasterCard Gold ose Debit MasterCard, shuma minimale për transaksion duhet të jetë 1.000 ALL (njëmijë lek).

2. Afati i lojës, sipas parashikimit të organizatorit

2.1 Loja promovionale do të zhvillohet gjatë periudhës 2 Nëntor 2020* deri më 30 Dhjetor 2020.

2.2 Shorteu për përzgjedhjen e fituesit do të hidhet çdo 2 (dy) javë, përkatësisht në datat që vijojnë: 16 Nëntor, 1 Dhjetor, 14 Dhjetor dhe 30 Dhjetor.

2.3 Loja Promovionale mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Banka nuk është përgjegjëse, d.m.th. që nuk mund të parandalohen, riparohen apo shmangen si dhe në rast të ndonjë urdhërimi sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen dhe çdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën e Fatit Promovionale, do të publikohet në <https://otpbank.al/>

3. Kriteret dhe kufizimet e pjesëmarrjes

3.1 Pjesëmarrësit në lojë do të jenë të gjithë subjektet (individë) që plotësojnë kriteret e mëposhtme në mënyrë kumulative përgjatë afatit të lojës promovionale:

i. Janë Klientë të "OTP Bank" Sh.a që kanë nënshkruar me Bankën Kontratën "KONTRATË PËR LËSHIM MASTER CARD GOLD" ose "KONTRATË PËR LËSHIM DEBIT MASTER CARD";

ii. Janë përdorues të njëjës nga kartat e debitit MasterCard Debit ose MasterCard Gold;

iii. Kryejnë gjatë 2 (dy) javësh kalendarike 3 (tre) ose më shumë blerje të suksesshme (në pikat e shitjes POS ose në Internet) me një nga kartat e debitit MasterCard Gold ose Debit MasterCard, ku shuma minimale për transaksion të jetë të paktën 1.000 ALL.

iv. Karta duhet të jetë e hapur deri në fund të fushatës. Nëse klienti e mbyll kartën para përfundimit të fushatës nuk do të jetë pjesë e lotarisë pavarësisht se plotëson kriteret e sipërpërmendura.

3.2 Punonjësit e "OTP Bank" SHA nuk do të jenë pjesë e lojës promovionale.

4. Mekanizmi dhe kriteret e lojës promovionale

4.1 Promocioni do të organizohet në formën e një loje dhe përzgjedhja e fituesve do të bëhet në mënyrë rastësore manualisht me anë të përzgjedhjes së goglave nga komisioni përkatës. Të gjithë klientët e bankës kanë në sistem një numër unik 6 shifror (NRP). Në 6 (gjashtë) vazo do vendosen gogla me numra dhe komisioni do të përzgjedhë nga një gogël për çdo vazo deri sa të formohet numri unik 6(gjashtë) shifror i klientit (NRP-ja). Komisioni përzgjedhës do të përbëhet nga një Noter publik i licencuar në RSH, përfaqësuesi i autorizuar me shkrim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit pranë Ministrisë së Financave, si dhe përfaqësues të tjerë nga Departamenti Ligjor, Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Produkteve të Bankës OTP Albania.

4.2 Subjektet (individë) që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes në këtë lojë promovionale nuk do të paguajnë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë lojë.

4.3 Një klient bëhet pjesë e shorteut përkatës nëse ka përmbushur kriteret e pjesëmarrjes të përcaktuara në nenin 3.1 të kësaj rregulloreje. Blerjet e kryera me kartën MasterCard nga Klienti i Bankës brenda 2(dy) javëve kalendarike nuk do të llogariten për shorteun pasardhës. Për tu bërë pjesë e shorteut pasardhës klienti duhet të plotësojë sërish kriteret e përcaktuara në nenin 3.1 të kësaj rregulloreje.

4.4 Data e kryerjes së blerjes do të konsiderohet data e kontabilizimit në sistemin e bankës.

4.5 Do të konsiderohen si transaksione të vlefshme vetëm ato veprime që do të jenë autorizuar si të suksesshme në sistemin e

bankës.

4.6 Transaksionet e anuluar/refuzuara nuk do të konsiderohet si pjesë e shumatores së transaksioneve të vlefshme.

5. Numri i çmimeve dhe mënyra e shpërblimit të fituesve

5.1 Në këtë lojë promovionale parashikohet të marrin pjesë afërsisht 10.000 klientë nga të cilët do të përzgjidhen 12 fitues (3 fitues për çdo 2 (dy) javë kalendarike).

5.2 Shorteu për përzgjedhjen e fituesit do të hidhet çdo javë, përkatësisht në datat që vijojnë: 16 Nëntor, 1 Dhjetor, 14 Dhjetor dhe 30 Dhjetor.

a) Në shorteun që do të hidhet më datë 16 Nëntor 2020 do të përfshihen transaksionet e kontabilizuara në datat 2 - 13 nëntor 2020;

b) Në shorteun që do të hidhet më datë 1 Dhjetor 2020 do të përfshihen transaksionet e kontabilizuara në datat 16 - 27 nëntor 2020;

c) Në shorteun që do të hidhet më datë 14 Dhjetor 2020 do të përfshihen transaksionet e kontabilizuara në datat 30 nëntor - 11 dhjetor 2020;

d) Në shorteun që do të hidhet më datë 30 Dhjetor 2020 do të përfshihen transaksionet e kontabilizuara në datat 14 - 30 dhjetor 2020;

5.3 Çdo 2(dy) javë do të përzgjidhen 3(tre) fitues.

5.4 Shorteu do të mbahet në ambientet e "Otp Bank" Sh.a në adresën: Twin Towers Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kulla 1, Tirana, Albania.

5.5 Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit pranë Ministrisë së Financave si dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë do të njoftohen me shkrim paraprakisht 20 ditë përpara për datën, orën dhe vendin kur do të zhvillohet shorteu dhe do të ndahen çmimet sipas specifikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196 datë 15.03.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kritereve dhe të rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale". Në rast se Banka ka kryer njoftimin si më lart, por përfaqësuesi/t e autorizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, nuk paraqitet/n personalisht në datën, orën dhe vendin ku zhvillohet shorteu, atëherë Banka do të vijojë me zhvillimin e shorteut dhe ndarjen e çmimeve. Megjithatë në këtë rast Banka do të informojë titullar/in/ët e organeve përkatëse për zhvillimin e shorteut dhe ndarjen e çmimeve.

5.6 Data, vendi dhe ora e hedhjes së shortit do të njoftohen paraprakisht edhe në faqen zyrtare të Bankës <https://otpbank.al/>.

6. Çmimet dhe vlera monetare e çmimeve të ofruara:

6.1 Çdo 2 (dy) javë do të shpërndahen 3 aparate celularë Samsung Galaxy S20 FE për tre fitues. Në total përgjatë afatit të lojës promovionale, do të shpërndahen 12 aparate celularë (3 (tre) telefona në 2 (dy) javë për 8 (tetë) javë) me një vlerë totale prej 894.000 Lek (tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë lek). Vlera e një aparati celular me TVSH është 74.500 Lek (shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind lek).

7. Njoftimi i fituesit

7.1 Pas hedhjes së shorteut, fituesit do të njoftohen në mënyrë telefonike nga ana e Bankës deri në 24 orë nga data e hedhjes së shorteut, në numrin e telefonit që kanë deklaruar në Bankë dhe që figuron i ruajtur në sistemet e bankës. Banka përjashtohet nga çdo përgjegjësi nëse Klienti ka ndryshuar numrin e telefonit dhe nuk ka njoftuar bankën zyrtarisht me shkrim për këtë ndryshim.

7.2 Mbas shpalljes së fituesve, organizatori i lojës do të përzgjedhë edhe 2 emra të tjerë (rezervë) vetëm në prani të komisionit, për secilën kategori, të cilëve do t'u akordohet çmimi në rast se ndonjë prej fituesve, nuk përgjigjet, nuk paraqitet në afatin e caktuar apo refuzon çmimin e ofruar nga banka.

7.3 Klienti fitues duhet të paraqitet pranë degës më të afërt të Otp Bank brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e hedhjes së shorteut. Nëse klienti fitues nuk paraqitet në një nga degët e Otp Bank brenda afatit të mësipërm, humb të drejtën e çmimit fitues. Bankës i lind e drejta t'ia kalojë çmimin klientit tjetër të përzgjedhur si fitues.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të kësaj loje promovionale.